

	<b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b> REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA <b>KOMUNA E RAHOVECIT</b> OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

<b>Për:</b>	<b>Grup i Operatorëve Ekonomik: N.T. “BITI – COM” &amp; N.N.SH. “VAAKAL” me adresë në Podujevë</b>  <b>Operatorëve Ekonomik</b>  <b>Të gjitha palëve të interesuar</b>
<b>Nga:</b>	Astrit Mullabazi, U.D. Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
<b>Lënda:</b>	<b>VENDIM</b> për Rishqyrtim të Kërkesës
<b>Datë:</b>	07.10.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për ri-shqyrtim** të datës: 03.10.2019, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: N.T. “BITI – COM” & N.N.SH. “VAAKAL” me adresë në **Podujevë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV**, Numri i Prokurimit: **623-19-6024-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-19-052-5-2-1**, **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV – Loto I**, nxjerr:

### VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: N.T. “BITI – COM” & N.N.SH. “VAAKAL” me adresë në **Podujevë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV**, Numri i Prokurimit: **623-19-6024-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-19-052-5-2-1**, **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV – Loto I**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 30.09.2019, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autortieti Kontraktues vendos të vazhdoj Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV**, Numri i Prokurimit: **623-19-6024-5-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-19-052-5-2-1**, **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MBJELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV – Loto I**, dhe mbështetë Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## Arsyetim

Grup i Operatorëve Ekonomik: N.T. "BITI – COM" & N.N.SH. "VAAKAL" me adresë në Podujevë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MJBELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV**, Numri i Prokurimit: **623-19-6024-5-2-1, Nr. i brendshëm: 623-19-052-5-2-1, KRIJIMI I HAPËSIRAVE GJELBERUESE DHE MJBELLJA E DRUNJËVE DEKORATIV – Loto I**, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 30.09.2019, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 03.10.2019, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

### Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

#### **Pretendimi 1:**

1. Per shkak se kemi dorëzuar Diplomen e agronomit si te pa noterizuar ne nuk pajtohem me kete pasi qe diploma e agronomit eshte e noterizuar nga NOTERI -XHAVIT DAKAJ me DT:31.10.2014 me Nr.rendor te noterit 35670. Ku eshte derguar ne dosjen e tenderit dhe kete duhet ta vertetoni.

**Përgjigje nga A.K:** Ky fakt nuk qëndron, pasi që tek oferta juaj, Diploma e agronomit nuk është e noterizuar sipas pretendimit tuaj, por e vërtetuar nga MASHT, gjegjësisht nga Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Xhavit Dakaj, me nr. 35670, e datës: 31.10.2019, andaj ky pretendim është i paqëndrueshëm sipas Dosjes së tenderit, pasi qe Xhavit Dakaj, nuk është noter, por Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit.

#### **Pretendimi 2:**

Ku ne si OE-N.T BITI-COM kemi dorëzuar nje liste te kontratave te kryer gjate tri viteve te fundit me vlerë 313.742,97 dhe kemi dorëzuar Referencat dhe Raportet e pranimeve teknike me shumen 264.132 72 ku i kemi ngarkuar ne PDF , murpo pas ngakrimit ne E-PROKURIM jane derguar vetem keto referenca dhe raporte teknike me shum prej 52.344,00 ku ka pasur ngarkim te PDF 13.50 MB dhe nuk jane derguar si duhet dhe pastaj ju si AK sipas ligjit te LPP-se nenit 72 eshte duhur te kerkoni sqarime shiteses per kete. Ndersa partneri tjetër i konzerciumit N.N.SH VAKAAL ka pas kontrata gjate tri viteve te fundit me vlerë 555.085 77 Euro kurse Referenca dhe pranime tekine ne shume prej 360.044 61 Euro ku ju si AK keni cekur se ka referenca dhe pranime teknike jo te ngjajshme me kerkesat e dosjes te tenderit , ku ne si lider OE-N.T BITI-COM mendojme se partneri jone OE.N.NSH VAAKAL ka referenca dhe raporte teknike te natyres se ngjajshme pasi qe keto jane te leshtuar nga DREJTORIA PER PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTE TE MJEDISIT drejtori kjo e cila ka te beje me mbrojte te mjedisit dhe planifikimit urban gje e cila ka te beje me kete tender. Ku ju si AK eshte dashur te sqaroni ne njoftimin per kontrate dhe ne dosjen e tenderit cilet Operator Ekonomik te kete te drejte te marre pjesë. Ne si OE-lider N.T BITI-COM mendojme se ju si AK KK RAHOVEC keni bere gjithmone parregullsi ndaj OE N.T BITI-COM dhe ne ndjehemi te diskriminuar nga ana juaj si AK .

**Përgjigje nga A.K:** Ky fakt nuk qëndron, pasi që ne si A.K Komuna e Rahovecit, e mbështesim **Letër standarde për tenderuesin e eliminuar, ku ju kemi informuar se:**

Sipas LPP – së tenderi juaj refuzohet pasi qe te Lista e projekteve te kryera në lëmin e punëve të ngjashme e dorëzuar nga lideri i konzerciumit: N.T. "BITI – COM", sipas *A01 Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, Neni 39. Sqarimi i Tenderëve*, thotë: Lista e kontratave te realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale te vlerës se përcaktuar, Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm Neni 69 i LPP-se.

Ku te lista e projekteve te prezantuar janë në vlerë prej: 313,742.97 €, dhe kjo liste eshte e pakompletuar sipas kerkese se AK – së, duke mos e cekur **datën e kontraktimit** te projekteve. Kurse te referencat e prezantuara nga lideri i konzerciumit: N.T. "BITI – COM", janë në vlerë prej: **52,344.00 €**, në tri vitet e fundit nga data e publikimit të Njoftimit për Kontratë. Ndersa anëtar i konzerciumit: **N.N.Sh. "VAAKAL"**, tek lista e projekteve te realizuara, në përgjithësi janë të natyrës së **Asfaltit**, dhe janë të papranueshme per ne si A.K. pasi qe Kërkesa 3, e Dojtes se tenderi thotë: **Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjashme**, sipas titullit të projektit.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër ketij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi  
U.d. Menaxher i Zyres se Prokurimit  
Komuna e Rahovecit